

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.4269/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DEVIZIONI PENAL në përbërje me gjyqtarin e vetëm gjykues Rustem Begolli dhe procesmbajtësen Sanije Troshupa, në lëndën penale kundër të pandehurit L.I.nga P., për veprën penale Ngacmim nga neni 186 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.Nr.5569/2017 të dt. 27.09.2017, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 22.02.2018, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Hava Krasniqi dhe i pandehuri L.I., në bazë të nenit 366 të KPPRK-së, me datë 23.02.2018, morri dhe në prezencën e palëve publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

L.I., nga i ati H. dhe nëna F., e gjinisë T., i lindur më ... në P., tani me vendbanim në, Rr.”S.”, me nr. ..., në K., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datë 07.09.2017 rreth ores 15:30 në P., në rrugën e U.-së, i pandehuri përfshihet në sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme, pas një mosmarrëveshje që kishin në mes veti, ata ishin ndarë para 4 muajve, por i pandehuri, nëpërmes rrjetit social “F.”, vazhdimisht e kishte penguar dhe shqetësuar të dëmtuaren, duke e përcjel dhe ngacmuar, duke tëntuar të lidhet përsëri me të, duke i thënë që nuk guxon të dalë me tjetër person se do të bëhet “gjaku deri në gu ti je e jemja” ashtu që tek e dëmtuara kishte shkaktuar frikë dhe shqetësim;-

- me këtë ka kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 186 par.1 të KPRK-së .

Andaj, gjykata, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 41; 43; 46; dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 248; 359 dhe 365 të KPPK –së, të pandehurit **L.I.** shqipton:

DËNIM ME GJOBË

I pandehuri L.I., dënohet në shumë prej **150 (një qind e pesëdhjet) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

Obiligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor do të paguaj shumën prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet e tjera procedurale në bazë të fletëshpenzimit të gjykatës.

E dëmtuara: L.A., me vendbanim në P., me numër të tel ..., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo – juridik.

Ar sy e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka ushtruar aktakuzën PP.II.Nr.5569/2017 të dt. 27.09.2017, kundër të pandehurit L.I.për shkak të kryerjes së veprës penale Ngacmimi nga neni 186 par. 1 të KPRK – së.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin P.nr.4269/17 të datës 30.10.2017 e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ka lëshuar Urdhër ndëshkimor përmes së cilit të akuzuarin L.I.e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale Ngacmimi nga neni 186 par. 1 të KPRK – së, dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) euro. Kundër këtij Aktgjykimi i pandehuri L.I.brenda afatit ligjor ka ushtruar kundërshtim.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datën 22.02.2018, gjatë së cilës seancë u dëgjuan prokurori i shtetit Hava Krasniqi dhe i pandehuri L.I..

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 22.02.2018 i pandehuri L.I., pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, ka deklaruar se e ka kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe ndihet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria e Shtetit.

Prokurori i shtetit Hava Krasniqi, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi se, me qenë se i pandehuri e pranoi fajësinë në përputhje me dispozitat e nenit 248 të KPPRK-së dhe njëherit pranimi i fajësisë është me përputhje të plot me provat të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga ana e të pandehurit gjykata në bazë të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi që është bindur plotësisht se i pandehuri ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë dhe se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e tij të plotë dhe se ky pranim është i mbështetur në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklaratimet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga i pandehuri, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit L.I.ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në hyrje të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të njëjtin pasi që më parë gjeti se penalisht është përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese se: i pandehuri ishte e sinqertë gjatë shqyrtimit gjyqësor, se e ka pranuar fajësinë, shpreh pendimin e tij, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, me bindje se kjo është e mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par.2, me

shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale,

ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pikat 2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.4269/17, dt.23.02.2018.

Procesmbajtësja
Sanije Trashupa

Gjyqtari i vetëm gjykues

Rrustem Begolli

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.